



TERMA E REFERENCE

Konsulent për Hartimin e Planit Lokal të Veprimit për Adresimin e Varfërisë Energjetike

Projekti: EnerPower: Nxitja e nismave lokale për të ulur varfërinë energjetike në komunitetet vulnerabël

Organizata kontraktuese: Insituti për Menaxhimin e Mjedist dhe Territorit (ETMI)



Sfondi i përgjithshëm

Projekti EnerPower: Nxitja e nismave lokale për të ulur varfërinë energjetike në komunitetet vulnerabël, synon identifikimin dhe zbutjen e varfërisë energjetike në Bashkitë Selenicë dhe Memaliaj, nëpërmjet angazhimit qytetar, rritjes së ndërgjegjësimit dhe ndikimit në politikëbërjen lokale dhe kombëtare. Ky projekt zbatohet nga organizata kryesore ETMI dhe ato partnere, CELIM Shqiperi dhe Gjelberimi 2000. Ky projekt zbatohet në kuadër të projektit "Green-AL" zbatuar nga Co-Plan dhe financuar nga qeveria Suedeze.

Projekti fokusohet në tre problematika kryesore:

- mungesën e monitorimit të strukturuar të varfërisë energjetike në nivel vendor;
- mungesën e bashkëpunimit ndërmjet pushtetit vendor, institucioneve të sektorit të energjisë dhe komuniteteve për identifikimin dhe adresimin e varfërisë energjetike;
- nevojën për mekanizma dhe incentiva financiare që mund të mbështesin familjet dhe komunitetet vulnerabël.

Në kuadër të projektit është realizuar monitorimi i varfërisë energjetike në të dy bashkitë dhe është hartuar një raport me gjetjet dhe rekomandimet kryesore. Raporti evidenton nevojën që lidhen me përmirësimin e kushteve të banimit, eficiencën e energjisë, sistemet e ngrohjes dhe ftohjes, pajisjet joeficiente, përballueshmërinë e kostove të energjisë dhe informimin e familjeve.

Projekti parashikon hartimin e një **Plani Lokal Veprimi të bazuar në të dhëna dhe analiza kontekstuale**, i cili duhet të identifikojë ndërhyrje të strukturuar dhe të realizueshme në nivel vendor. Plani duhet të orientojë bashkitë drejt masave konkrete, të përcaktojë përgjegjësitë institucionale, burimet e mundshme të financimit, mekanizmat e bashkëpunimit, afatet dhe indikatorët për monitorimin e zbatimit.

Një komponent thelbësor i Planit Lokal të Veprimit do të jetë **adresimi i varfërisë energjetike**, në përputhje me zhvillimet e reja të politikave kombëtare, veçanërisht me **Urdhrin nr. 147, datë 30.6.2026, "Për miratimin e Planit Kombëtar të Veprimit për adresimin e varfërisë energjetike dhe mbrojtjen e klientëve në nevojë të energjisë elektrike në Shqipëri, 2026–2030"**. Plani Lokal duhet të përkthejë orientimet kombëtare në masa të zbatueshme në kontekstin e Bashkive Selenicë dhe Memaliaj, duke marrë në konsideratë kompetencat e bashkive, situatën socio-ekonomike, karakteristikat e banesave, nevojat e familjeve vulnerabël, kapacitetet institucionale dhe mundësitë e financimit.

Objektivat e Planit Lokal të Veprimit

Plani Lokal i Veprimit duhet të synojë:

- Analizën e diagonzës dhe nevojave të identifikuar që lidhen me varfërinë energjetike në Selenicë dhe Memaliaj;
- Identifikimin e masave konkrete për eficiencën energjetike, informimin, mbështetjen sociale dhe aksesin në skema financimi;
- Forcimin e koordinimit ndërmjet strukturave vendore dhe institucioneve qendrore;
- Përcaktimin e përgjegjësive, afateve, burimeve të financimit dhe indikatorëve për zbatimin e masave;
- sigurimin që Plani të jetë në përputhje me kuadrin kombëtar ligjor dhe të politikave për varfërinë energjetike.



Qëllimi i konsulencës

Qëllimi i konsulencës është hartimi i një Plani Lokal të Veprimit për adresimin e varfërisë energjetike në Bashkitë Selenicë dhe Memaliaj, bazuar në **të dhënat e projektit, nevojat e identifikuar në nivel lokal dhe kuadrin kombëtar në fuqi**. Plani duhet të shërbejë si një dokument praktik për orientimin e masave, koordinimin e institucioneve, identifikimin e mundësive të financimit dhe monitorimin e progresit.

Plani duhet të:

- Bazohet në të dhënat dhe gjetjet e Raportit të monitorimit të Varfërisë Energjetike në bashkinë Memaliaj dhe Selenicë
- Reflektojë nevojat reale të komuniteteve në dy bashkitë;
- Integrojë kërkesat dhe prioritetet e Planit Kombëtar të Veprimit për Varfërinë Energjetike 2026–2030;
- Identifikojë qartë masat që mund të ndërmerren në nivel vendor;
- Identifikojë burimet dhe mekanizmat potencialë të financimit;

Objektivat specifike

Konsulenca synon:

1. Të përmbledhë gjetjet nga studimi i realizuar dhe ti përkthejë ato në prioritetet për ndërhyrje;
2. Të analizojë prioritetet nga Planit kombëtar i varfërisë energjetike dhe ti integrojë në planin lokal të veprimit.
3. Të identifikojë rolin, përgjegjësitë dhe mundësitë e ndërhyrjes së bashkive në adresimin e varfërisë energjetike.
4. Të identifikojë dhe prioritzojë masa konkrete dhe të realizueshme në nivel vendor.
5. Të përcaktojë mekanizmat e nevojshëm institucionalë, financiarë dhe të koordinimit për zbatimin e masave.

Detyrat dhe përgjegjësitë

Konsulenti/ja do të jetë përgjegjës/e për hartimin e Planit Lokal të Veprimit për adresimin e varfërisë energjetike dhe mbështetjen e komuniteteve vulnerabël në Bashkitë Selenicë dhe Memaliaj, duke u bazuar në të dhënat e projektit EnerPoër, konsultimet me aktorët lokalë dhe kuadrin ligjor dhe të politikave në fuqi.

1. Shqyrtimi i kuadrit ligjor, institucional dhe të politikave

- Të shqyrtojë legjislacionin dhe dokumentet relevante të politikave në fushën e energjisë, eficiencës energjetike, performancës energjetike të ndërtesave, mbrojtjes sociale, strehimit dhe zhvillimit vendor më një fokus tek Plani kombëtar i varfërisë energjetike;
- Të analizojë politikat dhe planet relevante kombëtare dhe vendore;
- Të identifikojë kërkesat, përgjegjësitë dhe mundësitë që lidhen me nivelin vendor;

2. Analiza e situatës aktuale

Konsulenti/ja do të analizojë të dhënat e studimit/diagonzës dhe burimet e tjera të disponueshme për të përgatitur një panoramë të situatës në secilën bashki. Analiza duhet të përfshijë, sipas disponueshmërisë së të dhënave:

- profilin socio-ekonomik të familjeve vulnerabël;
- përballueshmërinë e kostove të energjisë;
- nivelin dhe karakteristikat e konsumit të energjisë;
- kushtet e banimit dhe performancën energjetike të banesave;
- sistemet e ngrohjes dhe ftohjes;
- përdorimin e burimeve joeficiente ose të pasigurta të energjisë;
- aksesin në skema sociale dhe mbështetëse;
- problematikat dhe nevojat e identifikuara nga komunitetet;
- kapacitetet dhe mekanizmat ekzistues të bashkive.

Analiza duhet të evidentojë qartë problematikat dhe prioritetet për Bashkinë Selenicë dhe Bashkinë Memaliaj.

3. Hartimi dhe finalizimi i Planit Lokal të Veprimit

Konsulenti/ja do të hartojë dokumentin e plotë të Planit Lokal të Veprimit.

Drafti do të konsultohet me ETMI dhe partneret e projektit, bashkitë dhe aktorët relevantë dhe do të rishikohet mbi bazën e komenteve të marra.

Struktura orientuese e Planit Lokal të Veprimit

Plani duhet të përmbajë:

1. Përmbledhje ekzekutive
2. Problematikat dhe nevojat prioritare
3. Objektivat e Planit Lokal
4. Masat dhe nismat prioritare
5. Rolet dhe përgjegjësitë institucionale
6. Mekanizmi i koordinimit
7. Kostot orientuese dhe burimet potenciale të financimit
8. Matrica e zbatimit
9. Kuadri i monitorimit dhe raportimit
10. Rreziqet dhe masat zbutëse
11. Mekanizmi i rishikimit dhe përditësimit të Planit.

Kuadri ligjor referues

Gjatë hartimit të Planit Lokal të Veprimit, Konsulenti/ja duhet të analizojë dhe të sigurojë përputhshmërinë me:

- Urdhrin Nr. 147, datë 30.6.2026, dhe Planin Kombëtar të Veprimit për adresimin e varfërisë energjetike dhe mbrojtjen e klientëve në nevojë të energjisë elektrike në Shqipëri, 2026–2030, përfshirë Metodologjinë për Identifikimin dhe Monitorimin e Varfërisë Energjetike.
- Ligjin Nr. 37/2025 “Për performancën energjetike të ndërtesave”.
- Ligjin Nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” (ndryshuar me ligjin nr. 7/2018, datë 15.2.2018).
- Ligjin Nr. 124/2015 “Për Eficiencën e Energjisë” (Ndryshuar me ligjin nr. 37 datë 16/6/2025)
- Ligji nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”.



- Planet, programet dhe dokumentet në fuqi të Bashkive Selenicë dhe Memaliaj, veçanërisht ato për zhvillimin social, strehimin, planifikimin territorial, mjedisin, energjinë dhe investimet vendore.

Konsulenti/ja duhet të evidentojë për secilin instrument relevant detyrimet dhe mundësitë konkrete për bashkitë dhe t'i përkthejë ato në masa të zbatueshme në Planin Lokal të Veprimit.

Profili i kërkuar

- Diplomë universitare në energji, mjedis, biologji, ekonomi.
- Të paktën 7 vite përvojë profesionale në fushën e mbrojtjes së mjedisit, klimes dhe energjise
- Eksperiencë specike në projekte mbi varferinë energjitike dhe eficienten e energjise.

Kohëzgjatja

Konsulenca do të realizohet për një total prej **10 ditësh pune** me një buxhet 1400 euro (bruto) gjatë periudhës **Shtator-Tetor 2026**.

Dokumentet për aplikim

Kandidatët e interesuar duhet të paraqesin:

- CV të përditësuar; Referenca për përvojën në të paktën 2 projekte në fushën e varfërisë energjetike.

Dokumentet të dërgohen deri me datë **4.09.2026** në adresën: info@emti-al.org

Ky material është hartuar me mbështetjen e projektit GreenAL, i zbatuar nga Co-PLAN, COSV dhe VIS Albania. Pikëpamjet dhe përfundimet e përfshira këtu nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Qeverisë Suedeze ose të Sida-s, Agjencisë Ndërkombëtare Suedeze për Bashkëpunim për Zhvillim (Sida).